



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

LËNDA: GJUHË SHQIPE

(Klasa e pestë)

Tiranë, 2007

I. TË PËRGJITHSHME

Gjuha shqipe në këtë nivel të arsimit të detyruar shërben si bazë për formimin e përgjithshëm të nxënësit nga ana gjuhësore në zhvillimin dhe formimin intelektual, etik, estetik dhe qytetar të tij.

Veçori e zhvillimit të lëndës në klasën V, si klasa përmbyllëse e një cikli shkollimi brenda atij 9-vjeçar, është se studimi i gjuhës shqipe synon t'u japë nxënësve një paketë njohurish dhe aftësish. Ai synon të formojë shprehi të qëndrueshme komunikative, të cilat u nevojiten nxënësve në komunikim për nevoja vetjake në shkollë e më gjerë, krahas njohurive rreth sistemit gjuhësor, domethënë, rregullave më të përgjithshme të sistemit gramatikor të shqipes. Këto rregulla vijnë duke u zgjeruar nga klasat pararendëse II, III, IV në përshtatje me rritjen edhe me zgjerimin e gamës së interesave jetësore të vet fëmijës. Lënda e gjuhës shqipe në klasën V ka si veçori vazhdimin dhe çuarjen më tej cilësisht të angazhimit profesional, qytetar e misionar në dhënien e njohurive gjuhësore e komunikuese sipas parimeve specifike të organizimit të strukturës e të përmbajtjes së saj, përcaktuar në Kurrikulën e Re të 2004-ës, për *Mësimin e Gjuhës Shqipe në Shkollë* për klasat (1-9).

Përmes këtyre veçorive, programi i gjuhës shqipe në klasën e 5^{te} synon të sjellë dhe të krijojë disa hapësira dhe mundësi konkrete për risi të mirëfillta. Në këtë klasë, njohuritë gjuhësore do të shënojnë rritje në raport me ato të klasës IV dhe kthimi i tyre në shprehi e qëndrime do të realizohet përmes një strategjie të re bashkëkohore, e cila konsiston në kërkimin, gjetjen dhe përdorimin e teknikave të suksesshme të mësimdhënies, mësimnxënies, motivimit dhe vlerësimit për të realizuar dhënien, asimilimin dhe praktikimin e përmbajtjes së saj.

Janë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që nxënësi mban ndaj sistemit të shenjave dhe rregullave gjuhësore, ato që e bëjnë të komunikojë saktë, të njohë suksesin në rrethin e tij shoqëror, në familje dhe më gjerë. Nxënësi përmes këtij trekëndëshi të qëndrueshëm: *dije, shprehi dhe qëndrime*, do të arrijë të njohë, të japë mendimet dhe gjykimet e tij jo vetëm në lëndën e gjuhës shqipe, por në të gjitha lëndët. E parë në këtë prizëm, ajo përbën një ndër-lëndë.

Risia me një rëndësi themelore dhe që duhet trajtuar me profesionalizëm është përzgjedhja e metodave ndërvepruese dhe e teknikave bashkëkohore, që do të ndiqen për t'i zhvilluar orët e gramatikës së gjuhës shqipe dhe komponentët e saj, si: shqiptimi, drejtshkrimi, pikësimi, leksiku, gramatika, morfologjia dhe sintaksa, rendi i fjalëve në fjali, kultura gjuhësore. Kjo bën që konceptimi i lëndës së gjuhës shqipe të jetë *vendosja e njohurive gramatikore në shërbim të shprehive komunikuese*, pra nuk do të nisët nga gramatika për të mësuar gjuhën, por përmes gjuhës do të shkohet drejt saj.

Në Kurrikulën e Re të Gjuhës shqipe në shkollë 2004, për klasat I-IX theksohet se:

“Programi dhe të mësuarit e integruar ndihmon nxënësit të gjejnë shpejt dhe me lehtësi informacionin që u duhet, ta përpunojnë atë duke zbatuar aftësitë e fituara, duke i nxitur të mbajnë qëndrim dhe të marrin vendime për probleme të ndryshme në situata të caktuara të njohura ose jo, në shkollë dhe jashtë saj”. Që këtej do të kemi:

Qëllimi i mësimi të gjuhës shqipe është formimi i përgjithshëm intelektual dhe komunikues i çdo individi për realizimin e marrëdhënieve shoqërore. Ato realizohen përmes gjuhës dhe formimit të nxënësit me shprehi të plota dhe të qarta gjuhësore që do ta aftësojnë të përdorë gjuhën shqipe në nivel të pranueshëm nga të tjerët gjatë të folurit, të lexuarit e të shkruarit.

Përmbajtja e këtij programi synon të formojë tek nxënësit:

- Aftësinë për të kapur gjuhën, perceptimi ndaj gjuhës.
- Zotësinë dhe sigurinë në përdorimin e gjuhës.
- Zhvillimin e aftësive njohëse përmes gjuhës.
- Zhvillimin emocional dhe të imagjinatës përmes gjuhës.

AFTËSITË LINJAT	Aftësia e nxënësit për të perceptuar gjuhën	Zotësia dhe siguria e nxënësit në përdorimin e gjuhës.	Zhvillimi i aftësive njohëse përmes gjuhës te nxënësi.	Zhvillimi emocional dhe imagjinar i nxënësit përmes gjuhës.
Të dëgjuarit dhe të folurit	Zhvillimi i perceptimit në gjuhën e folur	Zhvillimi i aftësive dhe sigurisë në përdorimin e gjuhës së folur	Zhvillimi i aftësive njohëse përmes gjuhës së folur	Zhvillimi i botës emocionale dhe imagjinare përmes gjuhës së folur
Të lexuarit	Zhvillimi i koncepteve gjuhësore dhe shkruese në tekste të shtypura	Zhvillimi i aftësive të leximit për kënaqësi dhe për informim	Zhvillimi i interesit, qëndrimit dhe aftësisë për të menduar	Zhvillimi i metodave të të lexuarit
Të shkruarit	Shkrimi - krijimi dhe nxitja e impulsit të të shkruarit	Shkrim - zhvillimi i aftësive, sigurisë dhe saktësisë për të shkruar i pavarur	Shkrim-qartësimi i ideve përmes shkrimit	Zhvillimi i jetës imagjinare dhe emocionale përmes shkrimit

II. SYNIMET E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE

Programi i gjuhës shqipe për kl V zgjeron dhe thellon njohuritë e marra në klasat II, III, IV dhe forcon bazën mbi të cilën ndërtohet mësimi i kësaj lënde jo vetëm gjatë periudhës shkollore, por edhe më tej gjatë gjithë jetës.

Nga vetë emërtimi, Gjuhë shqipe, si lëndë parësore e me karakter kombëtar synon:

1. Të mundësojë formimin dhe zhvillimin vetjak intelektual, emocional, shoqëror, estetik dhe moral të çdo nxënësi.
2. Përvetësimin e gjuhës në atë nivel e cilësi që të mundësojë të mësuarit e vazhdueshëm gjatë gjithë jetës.
3. Të aftësojë nxënësit të realizojnë komunikimin me shkrim dhe me gojë për nevoja vetjake saktë dhe me kulturë gjuhësore.

III. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM TË GJUHËS SHQIPE NË KLASËN V

Mësimi i gjuhës shqipe në klasën V synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

- Nxënësi të komunikojë me të tjerët për qëllime e situata të ndryshme jetësore duke u aftësuar në përdorimin me saktësi të koncepteve gjuhësore dhe në raporte bashkëveprimi me njohuritë letrare nëpërmjet të folurit, të lexuarit e të shkruarit.
- Të rritë në mënyrë graduale aftësitë shprehëse, në përshtatje me karakteristikat e moshës, zhvillimit të tij emocional, shoqëror, estetik e moral.
- Të përdorë me vetëdije drejt, lirshëm njohuritë, konceptet gjuhësore e letrare nëpërmjet shprehjes së informacioneve, ndjenjave, ideve, imagjinatës dhe qëndrimeve të pranueshme për zhvillimin e tyre gjuhësor dhe intelektual, duke krijuar marrëdhënie nëpërmjet: dialogut, lojës, tolerancës dhe bashkëpunimit.
- Të zhvillojë vetëndërgjegjësimin e nxënësve për identitetin e tyre kulturor duke fituar edukatën e të lexuarit gjatë tërë jetës.

IV. LINJAT DHE NËNLINJAT E PROGRAMIT

■ Të dëgjuarit & Të folurit

1	Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime në mënyrë individuale dhe në grup.
2	Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publik me shumëllojshmëri qëllimesh
3	Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme.
4	Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare.
5	Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde

■ Të lexuarit

1	Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion
2	Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate, që të zgjerojë e të pasurojë botën e tij shpirtërore.
3	Të lexuarit për të për të reflektuar mbi idetë e tekstit.
4	Të lexuarit e teksteve të gjinive e llojeve letrare
5	Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje

6	Të lexuarit për të pasuruar njohuritë në drejtim të gjuhës standarde shqipe
---	---

■ **Të shkruarit**

1	Të shkruarit me karakter funksional
2	Të shkruarit për qëllime vetjake dhe më gjerë
3	Të shkruarit për t'u shprehur me ndjenjë dhe me imagjinatë
4	Njohuri rreth përdorimit të gjuhës

■ **Njohuri rreth sistemit të gjuhës**

1	Sintaksë
2	Morfologji
3	Leksikologji + fjalëformim
4	Kulturë gjuhe
5	Drejtshqiptim, drejtshkrim, pikësim.

IV. OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

Linja 1 : Të dëgjuarit dhe të folurit (15 orë)

Nënlinjat	Objektivat	Përmbajtja
1. Të dëgjuarit dhe të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime në mënyrë individuale dhe në grup.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të pyesë dhe të përgjigjet kur duhet t'u japë informacion të tjerëve dhe anasjelltas. ➤ Të kërkojë informacion shtesë për çështje të caktuara. ➤ Të përdorë fjalorin dhe sintaksën e duhur kur pyet ose përgjigjet. ➤ Të vlerësojë përgjigjet e marra vetëm në mënyrë të argumentuar. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Materiale me tematikë nga fusha të ndryshme të veprimtarisë së përditshme në shkollë, familje, shoqëri. ➤ Materiale të ndryshme kryesisht jo letrare që paraqesin interes për nxënësit.
2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grupe të vogla e të gjera.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dëgjojë dhe të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup. ➤ Të diskutojë në grup për çështje të caktuara. ➤ Të përshkruajë në mënyrë të hollësishme ngjarje dhe situata nga jeta e tij. ➤ Të luajë rolet që i caktohen në grupe të vogla dhe të mëdha. ➤ Të vlerësojë dhe të respektojë mendimet dhe idetë e shokëve. ➤ Të plotësojë me informacion shtesë planet e grupit. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tema që lidhen me çështjet shoqërore në përshtatje me moshën dhe që u përkasin fushave të ndryshme të marrëdhënieve njerëzore: mes pjesëtarëve të familjes, mes shokëve, me mësuesit.
3. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të	<ul style="list-style-type: none"> ➤ T'u përgjigjet pyetjeve që kanë lidhje me tekste të lexuara ose të dëgjuara nga të tjerët, duke argumentuar mendimin e tij. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tema sipas gjinisë e llojeve letrare për të cilat kanë interes fëmijët. ➤ Tekste për biseda të ndryshme me temë

<p>ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të flasë për tekste të ndryshme joletrare që janë në përshtatje me moshën e tij, që kanë strukturë dhe gjuhë të përshtatshme për t'u kuptuar nga të tjerët. ➤ Të dijë të pyesë, për çfarë të pyesë dhe kur të pyesë. ➤ Të japë mendime rreth përmbajtjeve dhe personazheve të pjesës sipas këndvështrimit të tij. ➤ Të japë mendime rreth teksteve letrare duke treguar dallime të thjeshta gjuhësore në tekstet që lexon. 	<p>të përcaktuar ose të lirë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Tekste të thjeshta letrare me fabul të thjeshtë. ➤ Tekste me tematikë të caktuar për moshën dhe me personazhe të pëlqyer nga nxënësit.
<p>4. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth llojeve dhe gjinive letrare</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dallojë saktë llojet dhe gjinitë letrare nëpërmjet poezisë, prozës së shkurtër, përrallës, tregimit, pjesës së shkurtër dramatike. ➤ Të krahasojë prozën me poezinë, prozën me dramën. ➤ Të përdorë intonacionin sipas llojit letrar për të cilin flet. ➤ Të interpretojë me role pjesë të llojeve letrare. ➤ Të rendisë ngjarjet sipas rendit kronologjik në formën e pikave të planit. ➤ Të përforcojë elementet e teknikës së recitimit të mësuara, për një të folur të qëllimshëm dhe të këndshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare në të cilat dallohen qartë tipare të llojeve e gjinive të ndryshme letrare. ➤ Pjesë që mund të luhen me role (prozë, poezi). ➤ Pjesë nga autorë vendas dhe të huaj; përshtatur për fëmijë, përmbledhje përrallash.
<p>5. Të folurit duke përdorur njohuritë e gjuhës standarde.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shqiptojë gjithnjë të gjithë tingujt e e një fjale dhe fjalën si njësi leksiko-gramatikore. ➤ Të përdorë saktë theksin e fjalës dhe theksin logjik në fjali. ➤ Të përdorë me vend kuptimet e fjalëve sipas situatës që i kërkohet. ➤ T'i përdorë fjalët e reja sipas kuptimeve që ato marrin 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë e shprehje të zgjeruara nga fusha të veprimtarisë jetësore të fëmijëve. ➤ Pjesë letrare ose joletrare me tematikë të caktuar për të pasuruar fjalorin.

	<p>në kontekste të caktuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të pasurojë fjalorin duke përdorur edhe skema të gatshme. 	
--	--	--

Linja 2: Të lexuarit (65 orë)

Nënlinja	Objektivat	Përmbajtja
<p>1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të lexojë në mënyrë lineare, të vëmendshme, të qëllimshme duke respektuar elemente, si: intonacioni, ritmi, grupet e fjalëve, shenjat e pikësimit. ➤ Të lexojë për të kuptuar përmbajtjen e tekstit. ➤ Të lexojë për të marrë informacion. ➤ Të bëjë pyetje rreth tekstit që lexon sipas qëndrimit dhe këndvështrimit vetjak. ➤ Të dallojë informacionin më të rëndësishëm, që t'i shërbejë si paragraf kyç në procesin e të kuptuarit. ➤ Të zgjerojë me detaje shtesë informacionin e marrë nga burime të ndryshme, si: libri, media e shkruar, enciklopedi etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tekste letrare dhe joletrare që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme. ➤ Shkrime të llojeve të ndryshme tematike të shtypit. ➤ Informacione për botën që e rrethon dhe më gjerë.
<p>2. Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të lexojë me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë, tekste të natyrave të ndryshme që i përkasin botës së tij. ➤ Të përdorë format e leximit shprehës. ➤ Të mësojë përmendësh pjesë në poezi e prozë dhe të fitojë elementet e para të interpretimit. ➤ Të interpretojë në grupe të vogla dhe grupe të mëdha materiale nga pjesë të shkurtra . 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tekste të llojit letrar e joletrar që nxisin për të lexuar deri në fund dhe që ngjallin emocione, dëshirë. ➤ Pjesë ku nxënësit gjejnë miqtë dhe heronjtë e ëndrrave të tyre nga autorë vendas dhe të huaj. ➤ Pjesë që nxisin ëndërrimin virtual moshor.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të bashkëbisedojë me personazhet e dashur për ëndrra të përbashkëta. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Literaturë e përshtatur për fëmijë.
3. Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e tekstit.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të tregojë brendinë e pjesës që lexon. ➤ Të ndajë pjesën në fragmente të veçanta, sipas kuptimit të tyre duke hartuar saktë pikat e planit. ➤ Të gjejë idetë dhe mesazhin e pjesës së lexuar duke i ilustruar ato me fragmentet përkatëse. ➤ Të ndajë mendimet e tij me bashkëmoshatarët dhe më të rriturit me qëllim pranimin e arsytimit të tij. ➤ Të dallojë personazhin kryesor të përzgjedhur nga vetë nxënësi duke arsyetuar zgjedhjen e tij. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tekste që i motivojnë nxënësit të reflektojnë idetë në mënyra të ndryshme: me anë të dramatizimeve, recitimeve, vizatimeve, lojërave, shkrimeve, poezive. ➤ Tekste që përshkruajnë mjedise ku veprojnë njerëz, kafshë në kohë të ndryshme.
4. Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të lexojë pjesë të llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare. ➤ Të klasifikojë elemente të gjuhës së prozës dhe poezisë, si: fjala, fjalia, paragrafi, dialogu, vargu, strofa, duke treguar funksioni artistik të tyre. ➤ Të marrë pjesë në interpretimin e përmbajtjes, në formën e përmbajtjes dhe ritregimit. ➤ Të dallojë tekstin letrar nga joletrar. ➤ Të arsyetojë pse pëlqen një gjini të caktuar letrare 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, si: përralla, tregimi, vjersha, gjëgjëza, pjesë të shkurtra dramatike. ➤ Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare në të cilat dallohen tipare karakteristike të tyre.
5. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të respektojë intonacionin e duhur gjatë leximeve me zë të lartë të pjesëve në poezi apo prozë për fjalët kyç, grup fjalësh dhe fjalitë. ➤ Të demonstrojë në të lexuar ritmin dhe theksin sipas llojit të tekstit. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë që mund të lexohen, recitohen apo interpretohen me role në mënyrë shprehëse. ➤ Pjesë për t'u lexuar nga mësuesi duke shërbyer si modele interpretuese për

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të imitojë zërin e një personi interpretativ. ➤ Të bëjë lexim interpretativ. ➤ Të lexojë me vëmendje në heshtje me qëllim dallimin e fjalëve kyç. ➤ Të lexojë në heshtje me qëllim përcaktimin e problemeve kryesore, personazheve kryesore, rrethanave karakterizuese. 	nxënësit.
6. Të lexuarit për të pasuruar njohuritë në drejtim të gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shqiptojë gjithnjë të gjithë tingujt e fjalët. ➤ Të përdorë saktë theksin të fjalët e njohura apo të reja. ➤ Të dallojë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalëve dhe të shprehjeve që i japin vlera artistike dhe gjuhësore materialit që lexon. ➤ Të dallojë termat: <i>përmbajtje, motiv, mesazh, ritregim</i>. ➤ T'i përdorë fjalët e reja sipas kuptimeve që ato marrin në kontekste të ndryshme. ➤ Të lexojë llojet e ndryshme të fjalive sipas intonacionit, shenjave të pikësimit etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë dhe tekste që pasurojnë të folurit e nxënësve sipas shqipes standarde. ➤ Materiale ku të përdoren termat <i>përmbajtje, ritregim, motiv, mesazh</i>.

Linja 3: Të shkruarit (15 orë)

Nënlinjat	Objektivat	Përmbajtja
1. Të shkruarit me karakter funksional	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shkruajë sipas modeleve të dhëna këshilla, udhëzime, njoftime, thirrje, përshkrime. ➤ Të paraqesë me shkrim fakte të thjeshta duke ruajtur vërtetësinë e tyre. ➤ Të shkruajë për lexues të ndryshëm. ➤ Të bëjë shkrime të shkurtra të natyrave të ndryshme, duke përdorur dialogun dhe ligjëratën e drejtë. ➤ Të shkruajë tregime të shkurtra ku të përdorë fjalë të 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Shkrime të modeluara të karakterit funksional të tilla, si: letra, ftesa, kujtime, përshkrimin e mjedisit ku jeton, thirrje për miqësinë. ➤ Modele të ndryshme të përshtatshme për këtë moshë të karakterit informues të tilla, si: enciklopedia për fëmijë, antologji për fëmijë etj.

	<p>zgjedhura në hyrje, zhvillim, mbyllje.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të plotësojë paragrafë të modeleve të ndryshme sipas karakterit përshkrues, përmbledhës, arsytues. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Modele gjysmë të gatshme ku nxënësi duhet të plotësojë fjali ose paragrafë që mungojnë.
<p>2. Të shkruarit për qëllime vetjake dhe më gjerë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të bëjë shkrime të ndryshme për nevoja vetjake (letër, urime, shënime të thjeshta, një fletë ditari, njoftime). ➤ Të shkruajë për të kërkuar ndihmë për diçka. ➤ T'u përgjigjet mesazheve të marra në formë ftesash, njoftimesh duke falënderuar. ➤ Të ndërtojë plane veprimtarish argëtuese, sportive. ➤ Të mbajë shënime vetjake, të qëllimshme për lëndë dhe disiplina shkencore të kurrikulës shkollore nga leximet e bëra në tekste apo përmes burimeve të ndryshme informimi. ➤ Të përdorë termat e duhura në një këshillë për rregullin në klasë, për një plan të thjeshtë veprimtarie, thirrje të thjeshta për veprime qytetare etj. ➤ Të përdorë fjalët dhe strukturat e duhura sintaksore që pasqyrojnë sjelljen qytetare të nxënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Modele shkrimesh ku shprehen nevoja vetjake: kërkon ndihmë, jep përgjigje me shkrim, lë mesazhe. ➤ Modele letrash të thjeshta. ➤ Modele shkrimesh ku bëhet fjalë për veprimtari të tilla, si: një festë në klasë, një veprimtari sportive, një veprimtari edukative në përshtatje me moshën. ➤ Materiale me tekste letrare dhe joletrare nga fusha të ndryshme ku nxënësit i kërkohet të bëjë përzgjedhjet e duhura.
<p>3. Të shkruarit për t'u shprehur me ndjenjë dhe me imagjinatë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të bëjë shkrime të ndryshme në të cilat nxënësi shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij sipas temës së kërkuar apo shkrimit të lirë. ➤ Të përdorë fjalë të reja dhe të "pazakonta". ➤ Të përshkruajë të afërm, shokë dhe kafshë të preferuara. ➤ Të përshkruajë personazhe nga krijimtaria popullore apo letrare 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Modele shkrimesh të ndryshme ku nxënësi gjen të shprehura ndjenja dhe emocione të ndryshme. ➤ Materiale të ndryshme që paraqesin situata jetësore të moshës së tyre. ➤ Tekste të ndryshme letrare me personazhe të dashur për fëmijë, si:

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përshkruajë ngjarje, mjedise, personazhe jo të vërteta duke u mbështetur në imagjinatën e nxitur nga fantazia njerëzore në përrallat, legjendat dhe krijimet fantastiko-shkencore. ➤ Të shkruajë me ndjenjë për përvoja vetjake. ➤ Të shkruajë për vende që ka parë, jetuar apo i imagjinon. ➤ Të parashikojë zgjidhje, mbyllje të reja të tregimeve sipas imagjinatës. 	<p>mamaja, gjyshja, një shok ose shoqe, një kafshë shoqërimi, qenie jashtëtokësore etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përralla të shkurtra, legjenda, fabula me personazhe fantastikë si: Eëinx-sat, Sailermoon, Bratza-t, Gogu, Spaiderman etj. ➤ Tekste të shkurtra me karakter fantastiko-shkencor. <i>Ilustrime me figura mbi bazën e të cilave shkruajnë ndodhi sipas fantazisë së tyre së tyre.</i>
<p>4. Njohuri rreth përdorimit të gjuhës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të respektojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të modelit të shkrimit. ➤ Të përdorë me vend shenjat e pikësimit në fjali të tipave të ndryshme. ➤ Të përdorë me vend terminologjinë nga fusha e të shkruarit dhe sistemit të gjuhës. ➤ Të vetëvlerësojë shkrimin e tij dhe të vlerësojë shkrimin e shokut. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Lloje dhe modele shkrimi me fjali të tipave të ndryshëm: dëftore, pyetëse, dëshirore, thirrmore dhe shenjat përkatëse të pikësimit. ➤ Terminologji gjuhësore, si: <i>titulli, hyrje, paragraf, zhvillim, mbyllje, arsyetim.</i>

Linja 4: Njohuri rreth sistemit gjuhësor (55 orë)

Nënlinjat	Objektivat	Përmbajtja
<p>1. Sintaksë 19 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të ndërtojë drejt fjalinë duke patur si bazë fjalën si njësi leksiko-gramatikore, logjikën e thënies, intonacionin e përfunduar. ➤ Të gjejë fjalitë që formojnë një paragraf. ➤ Të gjejë paragrafët që formojnë një tekst. ➤ Të renditë sipas rrjedhës logjike paragrafët në hartimin e një teksti. ➤ Të shkruajë një tekst të shkurtër. ➤ Të kryejë veprime me grupet e fjalëve në fjali. ➤ Të gjejë fjalinë më të vogël nëpërmjet veprimeve me grupet e fjalëve në fjali. ➤ Të dallojë grupin emëror dhe grupin foljor në fjali. ➤ Të dallojë kryefjalën e shprehur me emër, përemër, GE. ➤ Të dallojë kryefjalët homogjene. ➤ Të analizojë funksionet brenda grupit emëror dhe grupit foljor. ➤ Të dallojë përcaktorin brenda grupit emëror. ➤ Të identifikojë përcaktorin e shprehur me emër, mbiemër, përemër, numëror. ➤ Të dallojë përcaktorin homogjen. ➤ Të identifikojë kundrinorin . ➤ Të përdorë kundrinorët në fjali. ➤ Të dallojë kundrinorin homogjen. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Teksti dhe fjalia ➤ Fjalia, përbërësit e saj dhe funksionet e tyre. ➤ Fjalia e thjeshtë më e vogël dhe e zgjeruar. ➤ Përbërësit e fjalisë Grupi emëror, grupi foljor ➤ Kryefjala ➤ Përcaktori ➤ Kundrinori

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përdorë rrethanorin si plotës të grupit foljor në pozicione të ndryshme. ➤ Të dallojë rrethanorin homogjen. ➤ Të përcaktojë llojin e fjalive sipas kumtimit. ➤ Të ndërtojë fjali dëftore. ➤ Të dallojë fjalitë pyetëse tërësore dhe të pjesëshme. ➤ Të ndërtojë fjali pyetëse. ➤ Të ndërtojë fjali dëshirore ➤ Të ndërtojnë fjali nxitëse. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rrethanori Tipet e fjalisë sipas kumtimit ➤ Fjalitë dëftore ➤ Fjalitë pyetëse ➤ Fjalitë dëshirore ➤ Fjalitë nxitëse
<p>2. Morfologji 19 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përcaktojë klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. ➤ Të ballafaqojë emrat e përgjithshëm nga të përveçëm, konkretë nga abstraktë. ➤ Të përcaktojë gjininë e emrit. ➤ Të përcaktojë numrin e emrit. ➤ Të përcaktojë rasën e emrit. ➤ Të dallojë mbiemrin sipas veçorive të tij gramatikore (gjinia, numri, rasa, i nyjshëm, i panyjshëm). ➤ Të dallojë përemrin vetor. ➤ Të lakojë përemrin vetor. ➤ Të gjejë trajtat e shkurtra. ➤ Të dallojë përemrin pyetës (kush, cili, çfarë, ç). ➤ Të përdorë përemrin pyetës në fjali. ➤ Të dallojë përemrin lidhorë (që, i cili). ➤ Të përdorë përemrin lidhorë në fjali. ➤ Të dallojë përemrin e pacaktuar. ➤ Të përdorë përemrin e pacaktuar në fjali. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Klasat e fjalëve ➤ Emri ➤ Mbiemri ➤ Përemri vetor ➤ Përemri pyetës.(Format, përdorimi i përemrave pyetës) ➤ Përemri lidhor.(Format, përdorimi i përemrave lidhorë) ➤ Përemri i pacaktuar. (Llojet, forma, përdorimi)

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përcaktojë mënyrën e shprehjes së veprimit nga folja. ➤ Të dallojë tri njësitë kohore të foljes dhe nëndarjet e tyre. ➤ Të dallojë lidhëzat. ➤ Të dallojë parafjalët bazë të rasës emërore, kallëzore e rrjedhore. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Folja ➤ Lidhëzat ➤ Parafjala
<p>3. Drejtshkrim + Pikësim 10 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përdorë me vend shenjat e pikësimit: (.) (,) (;) (') (:) (?) (!) (!?) (“,”) (-) sipas intonacionit të thënies. ➤ Të përdorë saktë shenjat e pikësimit në dialog. ➤ Të përdorë saktë shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë. ➤ Të përdorë shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, tek emrat e përveçëm dhe në rastet e tjera, si: emërtimet e rrugëve, institucioneve etj. ➤ Të shkruajë drejt emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me mbaresën -e dhe -ra gjatë lakimit të tyre. ➤ Të përdorë drejt apostrofin te trajtat e shkurtra. ➤ Të përdorë drejt apostrofin tek përemri pyetës ç’. ➤ Të ndajë drejt fjalët në fund të rreshtit. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tekste të shkurtra që argumentojnë përdorimin e (.) (,) (;) (') (:) (?) (!) (!?) (“,”) (-) ➤ Shenjat e pikësimit në dialog. ➤ Shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë. ➤ Shkronja e madhe. ➤ Emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me mbaresën -e dhe -ra gjatë lakimit të tyre. ➤ Përdorimi i apostrofit në trajtat e shkurtra, të bashkuara . ➤ Të përdorë saktë apostrofin te përemri pyetës ç. ➤ Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përdorë drejt zanoret i dhe y. ➤ Të përdorë drejt zanoret u dhe y. ➤ Të zbatojë rregullat drejtshkrimore gjatë shkrimit me të kopjuar, diktuar ose në krijime. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përdorimi i zanores i dhe y ➤ Përdorimi i zanores u dhe y
3. Leksikologji Fjalëformim 5 orë	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përcaktojë kuptimet e fjalës. ➤ Të dallojë fjalët sinonime dhe antonime. ➤ Të krijojë çifte sinonimie dhe antonimie. ➤ Të gjejë përbërësit e fjalës. ➤ Të përdorë shprehjet frazeologjike të thjeshta në situata të ndryshme. <p>Të përdorë fjalorin për qëllime të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Fjala si njësi më e vogël e kuptimshme e gjuhës. ➤ Sinonimet dhe antonimet ➤ Përbërësit e fjalës ➤ Shprehjet frazeologjike ➤ Fjalori
4. Kulturë gjuhësore 2 orë	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dallojë fjalët dialektore të gjuhës shqipe. ➤ Të dallojë fjalët e gjuhës standarde nga ato dialektore. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Dialektet ➤ Gjuha standarde

V. TABELA PËRMBLEDHËSE E SHPËRNDARJES SË ORËVE

Nr	Linjat	%	Nr i orëve	Nënlinjat		orë
I	Të dëgjuarit & të folurit	8,5%	15	1	Për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	
				2	Të dëgjuarit dhe të folurit në grupe të vogla dhe të gjera.	
				3	Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme.	
Orët e lëndës së gjuhës shqipe kanë të integruar punën e planifikuar me të folurit dhe të						

dëgjuarit. Edhe pse janë shënuar 15 orë në tabelën I, faktikisht në strukturën e zbatuar programore, kjo linjë do të zërë një % shumë më të madhe të kohës mësimore për vetë karakterin specifik të lëndës. Ajo del ne pah pothuajse në të gjitha orët.				4	Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe gjinive letrare.
				5	Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde.
II	Të lexuarit	37%	65	1	Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion.
Po kështu edhe për linjën e të lexuarit, është respektuar ndarja e orëve të të lexuarit në strukturë, ku zë 37% të programit lëndor, por kjo % rritet në të vërtetë gjatë praktikës mësimore, sepse edhe në linjat e tjera do të integrohet të lexuarit.				2	Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate.
				3	Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e pjesës dhe në stilin e shkrimtarit.
				4	Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare.
				5	Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje.
				6	Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe.
				II	Të shkruarit
Për vetë rëndësinë që kjo linjë ka në praktikën mësimore dhe më gjerë, në jetën e përditshme të secilit nxënës edhe pse në tabelën III paraqitet				2	Të shkruarit për nevoja vetjake, duke e përdorur atë për shumëllojshmëri qëllimesh.

me 15 orë, faktikisht në strukturën lëndore vjetore zë gati trefishin e tyre. Të shkruarit ka rreth 40% të sasisë së kohës mësimore aktive në klasë.				3	Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë.	
				4	Të shkruarit duke praktikuar njohuritë rreth gjuhës.	
I	Njohuri rreth sistemit	37%	55	1	Sintaksë	19 orë
V	gjuhësor			2	Morfologji	19 orë
Edhe për linjën e tabelës IV do të funksionojë e njëjta logjikë. Ajo është konceptuar jo vetëm si linjë më vete, por e përfshirë edhe në linja të tjera.				3	Leksikologji+fjalëformim.	5 orë
				4	Kulturë gjuhe	2 orë
				5	Drejshqiptim, drejtshkrim, pikësim	10 orë
V	Kurrikulë e lirë	15%	25 orë	Orët do të planifikohen nga mësuesi . Në program është paraqitur një rubrikë në ndihmë të tij për përdorimin e orëve të lira.		

Zbatimi i kurrikulës së lirë

Qëllimi i **Orëve të lira** (15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe të përparësive arsimore që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimit.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël.

- Është i detyrueshëm, sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor.
- Është fleksibël, sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Materiali mësimor që do të përgatitet dhe do të përzgjidhet nga mësuesi duhet t' shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të përgjithshme të lëndës së gjuhës shqipe si lëndë formuese në edukimin global të nxënësve, si një ndërlëndë, rrezatimi i rezultateve të së cilës kushtëzon mbarëvajtjen e tyre në lëndët e tjera të sistemit kurrikular dhe ekstrakurrikular.

Grumbullimi, sjellja në klasë dhe përdorimi i materialeve të ndryshme, nga fusha të ndryshme të veprimtarisë intelektuale dhe praktike të njerëzimit, materiale letrare dhe joletrare, grafikë, diagrame, materiale nga media e shkruar dhe elektronike, interneti, arkeologjia, astronomia, ekologjia, shëndeti i fëmijës, lojëra të popujve të ndryshëm, edukimi qytetar, fjalorth i specializuar për fusha që paraqesin interes për moshën etj, mund të kthehen në burime të vlefshme për të organizuar orë mësimore “pa mure” që janë interesante dhe bëhen promotorë edhe të zgjedhjeve afatgjata të nxënësve në jetë.

Organizimi i veprimtarive në natyrë, jashtë mureve të shkollës duke shfrytëzuar kushte të mjedisit në të cilin është shkolla, të shoqëruara me veprimtari praktike; *organizimi i vizitave në Biblioteka, teatro, muze, shtëpi-muze shkrimtarësh, thjesht vende me bukuri natyrore të spikatur të vendit tonë, pra vende dhe qendra të rëndësishme për kulturën shqiptare, për historinë e kombit që kanë ndikuar fuqishëm në identitetin kulturor kombëtar, të shoqëruara me vrojtime dhe me detyra do të jetë një paketë praktikash në shërbim të realizimit të objektivave të caktuara të programit. Kjo paketë hap shtigje për veprimtari të tjera. Kështu mund të bëhet:*

- Organizimi i konkurseve të fjalës artistike.
- Organizimi i konkurseve “Lexuesi më i mirë”.
- Organizimi i konkurseve “Veprimtaria më e mirë në shërbim të ruajtjes së mjedisit”.
- Organizimi i lojërave të ndryshme zbavitëse që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive intelektuale dhe pjesëmarrëse, që fuqizojnë të nxënët edhe zhërvjelltojnë procesin e mësimdhënies, që zhvillojnë të menduarit logjik dhe kritik.
- Përforcimi i njohurive përmes improvizimeve të dramatizuara apo lojës me role,
- Organizimi i konkurseve për dramatizimin më origjinal.
- Shkëmbim letrash me qëllim përforcimin e njohurive të marra në kapitullin e punës me shkrim, të shoqëruara me metoda dhe strategji që fuqizojnë si mësimdhënien ashtu edhe të nxënët duke luajtur.
- Organizimi i konkursit “Shkrimi më i bukur”.

- Intervista interesante në bashkëpunim edhe me prindërit për përvoja të përbashkëta edhe pse në kohë të ndryshme.
- Përralla, legjenda dhe material folklorik nga krahina prej së cilës janë.
- Ekspedita folklorike, arkeologjike dhe raportimi me shkrim i punës së kryer.

Të vendosura në rubrikën e *orëve të lira*, këto janë disa veprimtaritë rekomanduese që sugjerohen të zhvillohen nga mësuesi në kuadrin e 25 orëve që ai ka në përdorim.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve, rritjen e efektshmërisë së kurrikulës së shkollës mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh (në formën e një projekti ose të një teme komplekse) për të programuar dhe zhvilluar veprimtari të përbashkëta që shfrytëzojnë lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspekte kroskurrikulare. Nxënësve u jepen detyra që përfshijnë njohuri ndërlëndore dhe i shërbejnë arritjes së objektivave të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duke i gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës së orëve të lira. Kjo do të mundësohet duke analizuar me kujdes si programin ashtu edhe kërkesat që parashtrojnë veçoritë vendore ku gjendet shkolla.

Realizimi i sugjerimeve të mësipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por edhe aftësinë e një hartuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart në vetvete ky rol.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë, të cilat jo vetëm që nuk shënojnë risi, por ia humbin karakterin inovativ kësaj rubrike në kurrikulën shkollore.

VI. INTEGRIMI

1. Mënyrat e integrimit

- Integrimi ndërlëndor (gjuhe shqipe, tekste letrare dhe joletrare të llojeve dhe gjinive të ndryshme).
- Integrim ndërmjet fushave të studimit (linjave dhe nënlinjave).
- Integrim në planin e bashkëveprimit të objektivave për çdo fushë.
- Integrim në përdorimin e metodave ndërvepruese në mësimdhënie.
- Integrimi nëpërmjet zërthimit të përmbajtjes lëndore nëpërmjet fushave të veprimtarisë së nxënësit.
- Integrim përmes zërthimit të objektivave themelore si lëndë me objektiva specifike.
- Lënda e gjuhës shqipe është bazuar në integrimin e ndërlëndor që do të thotë se zbatuesit e këtij programi duhet:
 - të realizojnë parimin e integrimit natyrshëm, të njohurive bazë nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes, dhe mes fushave të tjera të dijeve, të tilla, si: arti i fjalës, historia, gjeografia, matematika, teknologjia, edukata qytetare, ruajtja e mjedisit etj.
 - të prezantojnë me njësi mësimore dhe me linja të caktuara qëllim që të realizojnë integrimin dhe synimete larmishme mësimore.
 - të zbatohet integrimi në program përmes respektimit të larmisë tematike.

2. Integrim në metodë

- Mësuesi të vendosë nxënësin në qendër të procesit mësimor duke u bazuar në studime të didaktëve të shquar të traditës ose bashkëkohore shqiptare e botërore si edhe në përvojat jetësore të tij.
Në përfshirjen dhe përdorimin e metodave, e mjeteve bashkëkohore didaktike për të rritur efektshmërinë e orës së mësimit dhe gjithpërfshirjen e nxënësve, duhet të shoqërohet dhe zhvillohet përmes përdorimit të materialeve të komunikimit masiv bashkëkohor, të siguruara nga burime alternative.

VII. VLERËSIMI

Një nga proceset bazë që qëndron në themel të të mësuarit të lëndës së gjuhës shqipe është vlerësimi i njohurive të nxënësve. Ky proces ashtu si në klasat pararendëse shënon përgjegjësi të rëndësishme dhe sigurisht kërkon përmirësim të vazhdueshëm në kontakt me parametrat bashkëkohorë.

Synimet e vlerësimit janë:

- Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm mbi nivelin e njohurive, motivimin e tyre drejt të mësuarit duke përcaktuar mundësitë e tyre reale për nxënie.
- Shkalla e realizimit të objektivave të përcaktuara në programin mësimor.
- Nxitja e interesit të nxënësit për ngritjen e nivelit të arritjeve të tyre.

Komponentët e vlerësimit janë:

Vlerësim i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim.

- Për vetë natyrën e lëndës dhe rëndësinë e madhe të vlerësimit të aftësive komunikuese, vlerësimi i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim është i domosdoshëm dhe udhëheq punën e përditshme mësimore në lëndën e shqipes. Në dobi të nivelit të punës vlerësuese është pa dyshim vendosja e kriterëve vlerësuese, njohja e standardeve, që duhen konsideruar piketa të përcaktuara profesionalisht, si rezultate të pritshme që duam të arrijmë. Në këtë linjë është edhe vlerësimi i nxënësit dhe niveli i punës së bërë prej tij sipas standardeve të arritjes.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; të jenë të tilla që t'i motivojnë ata.

Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

VIII. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përvetësimi i programit të gjuhës shqipe klasa V bëhet cilësor, kur mësuesi mundëson që:

- Nxënësit të sjellin përvoja personale, interesa, qëndrime të caktuara ndaj dukurive gjuhësore në orën e mësimit.
- Në përshtatje me synimet dhe objektivat e vënë, ata adaptojnë një seri rolesh në procesin e të nxënët (*atë të ftuesit në bashkëpunim, dëgjuesit të vëmendshëm, inkurajuesit, udhëheqësit, mbështetësit, nxitësit, motivuesit, lehtësuesit, vlerësuesit etj*).
- Ora e mësimit të shoqërohet me rubrika të pasura, paraqitje skemash dhe grafikësh të thjeshtë të tilla, si ato që nxënësi has në jetën e përditshme, pasi ndërthurja e tyre synon ta mundësojë natyrshëm integrimin.
 - Rimarrja të jetë pjesë e mësimit të gjuhës shqipe, me qëllim lidhjen dhe përfundimin e shprehive letrare dhe gjuhësore.
 - Të nxënët të realizohet përmes nxitjes për të qenë aktivë dhe për të marrë përgjegjësi për zgjedhje dhe qëndrime .
 - Nxënësve t'u jepen shanse të dinë më shumë për dukuritë dhe ligjësitë gjuhësore dhe letrare.
 - U jep përparësi ushtrimeve, praktikimit të asaj që nxënësit dinë të bëjnë larg mbingarkesave teorike, duke e kaluar mësimdhënien nga riprodhuese, në një mësimdhënie ku nxënësi *kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon, provon madje të kalojë edhe në sintezë.*
 - Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla, si; *të folurit në grupe të vogla e të mëdha, të lexuarit shprehës dhe recitimi, të shkruarit, të shkruarit për qëllime të ndryshme dhe në fusha të ndryshme* të jenë pjesë përbërëse e çdo ore mësimi, si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike, si në temat nga fusha e letërsisë dhe të disiplinave të tjera shkollore (përmes teksteve joletrare), ashtu edhe në temat nga fusha e gjuhës shqipe.
 - Punët me shkrim të tipit *ese, shkrim i lirë, përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruarit*, edhe pse të thjeshta, të jenë të paraprirë nga njohje, analiza, imitim krijimesh të të njëjtës natyrë, shkëputur nga trashëgimia jonë letrare dhe ajo botërore.
 - Veprimtaritë të jenë të shpeshta dhe me tematikë të larmishme, nxitëse gjithëpërfshirëse, kërkimore dhe zbatuese.
 - Kërkesa për punë me shkrim për çdo temë mësimi në procesin mësimor, të mos varet apo plotësohet **vetëm** nga orët e veçanta të planifikuara për to në program, por doemos të bëhet pjesë përbërëse e shtjellimit të plotë të temës përkatëse, duke shtuar edhe kërkesa që lidhen me modelimin e shkrimit.
 - Ushtrime dhe forma pune ndërvepruese të jenë në strukturën e zbatuese të programit.
 - Procesi mësimor të pasurohet dhe të shoqërohet me *tabela, grafikë, foto dhe skica* të tjera, që shoqërojnë natyrshëm materialin verbal të shkruar.
 - Të shmanget mbingarkesa mësimore dhe të përdoret terminologjia e thjeshtuar, në përshtatje me moshën dhe ruajtjen e sensit të masës në dhënien e koncepteve apo detyrave mësimore.
 - Pjesët përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe e huaj të jenë në përshtatje me moshën e fëmijëve të klasës së pestë dhe të plotësojnë kriteret didaktike të gjetësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës. Ato duhet t'u jepen nxënësve këndshëm duke e kthyer kohën që fëmija qëndron në shkollë në kohën më të bukur të ditës.